



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog  
Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and  
Finance Committee

32	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	22.01.2021 në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjerë:</b>	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Drejtorët: Hysni Maxharraj, Hazbi Bajraj, Mujë Osmanaj, Drin Sadikaj, Lulzim Blakaj, Demë Qeta, Zyrtar Administrativ: Zekije Sutaj, Flora Bujupaj, Fjollë Berisha.
<p style="text-align: center;"><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit,</li><li>2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 18.11.2020,</li><li>3. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e katërt (tetor-dhjetor) të vitit fiskal 2020,</li><li>4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2020,</li><li>5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunal në Istog për vitin 2021,</li><li>6. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës,</li><li>7. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,</li><li>8. Marrja e vendimit për shfuqizimin e vendimeve:<ol style="list-style-type: none"><li>1- 01 Nr.17/2013, i datës 29.03.2013,</li><li>2 -01 Nr.68/2016, i datës 30.06.2016,</li><li>3- 01 Nr.29/2019, i datës 29.03.2019,</li><li>4- 01 Nr.30/2019, i datës 29.03.2019,</li><li>5 -01 Nr.31/2019, i datës 29.03.2019,</li><li>6 -01 Nr.32/2019, i datës 29.03.2019,</li><li>7 -01 Nr.33 2019 , i datës 29.03.2019,</li></ol></li></ol>	

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj**, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjerë janë pajisur me maska, doreza dhe dezinfektues në tavolina.

Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Fjalën ja kalon Drejtorit të për Buxhet dhe Financa z. Hysni Maxharraj

**Hysni Maxharraj** – përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë, që pika numër 3 raporti i TM4 të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kryesuesi hedh në miratim propozimin e drejtorit:

Miratohet një zëri, që raporti i TM4 të shtyhet për mbledhjen tjetër

Po vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, me këtë propozim që të shtyhet pika 3 për mbledhjen e ardhshme.

**Kush është që të miratohet rendi i ditës me këto pika.**

**Miratohet rendi i ditës në zëri.**

Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit

**Vendimet:**

**Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 1.****Diskutimet:**

**Kryesuesi** – Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatohet që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.

**Vendimet:**

Vazhdojmë me mbledhjen

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 2.****Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën tjetër të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

<p>a ka dikush diçka?  Pasi që diskutime nuk pati hedh në miratim.  Miratohet një zëri procesverbali nga mbledhja e kaluara. Të gjithë anëtarët e Komitetit prezent.</p>	
<b>Vendimet:</b>	
<b>Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.</b>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 3.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
<p><b>Kryesuesi</b>, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2021, materialin e keni pasur nuk është shumë voluminoz është në pika të shkurtër i nxjerrë nëse dikush dëshiron diçka të shtohet apo të ndryshohet ju lutem propozoni raporti është i Kuvendit të gjitha punët dihen.  A ka dikush diçka rreth këtij raporti.  Në mënyrë unanime anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa ja përcjellin Kuvendit për shqyrtim.</p>	
<b>Vendimet:</b>	
<b>Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyrë unanime: raportin e punës së Kuvendit për vitin 2020, i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.</b>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 4.</b>	
<p><b>Kryesuesi</b>, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës në Istog për vitin 2021.  Të nderuar anëtarë të Komitetit, Planin e keni pasur në material keni pasur kohën e mjaftueshme, Plani është i punuar nga komisioni që është zgjedhur në Kuvend. Ky plan gjatë kohës sa është në zbatim ka edhe ndryshime edhe mund të ketë pika tjera që shtohen nga ekzekutiv.  Nëse ka dikush diçka rreth Planit ju lutem urdhëroni.  Pasi që diskutime apo propozime tjera nuk pati  Hedh në miratim:  Në mënyrë unanime konstatojmë që Komiteti për Politikë dhe Financa ja përcjellë Kuvendit Komunal këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim.</p>	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
<b>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon që: Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Istogut për vitin 2021. Ta dërgojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.</b>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 5.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj**, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, fjalën ja kalon z. Lulzim Blakaj drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

**Lulzim Blakaj**, përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Projekt- Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës.

**Eliot Kukiqi** - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua ta pyes drejtorin ne si kuvend e kemi një komision për dhënien e pronës komunale, a bie ndesh kjo me e formuar një komision tjetër si shkon kjo procedura.

**Lulzim Blakaj** - është kjo hapësira prej zero deri në një vit për personat fizik dhe juridik, dhe komisioni formohet nga Kryetari i komunës, nuk bie ndesh me atë komisionin e KK.

**Kryesuesi i Kuvendit** - a ka dikush diçka rreth kësaj Rregulloreje, pasi qe nuk ka pyetje apo diskutime tjera.

Hedh në miratim këtë Rregullore.

Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, i rekomandojnë Kuvendit të Komunës Shqyrtimin dhe miratimin i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës.

**Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.**

#### Vendimet:

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanim rekomandon: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 6.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj**, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba. Fjalën ja kalon z. Hysni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa.

**Hysni Maxharraj**, përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba.

- Bashkëbiseda me ekzekutivin dhe anëtarët e KPF-së, për taksat e kësaj rregullore.

<b>Kryesuesi i Kuvendit</b> - Pasi që diskutime tjera nuk pati, konstaton që Komiteti i rekomandon të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba.	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që: Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba, t'ia kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 7.</b>	
<p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Marrja e vendimit për shfuqizimin e vendimeve:</p> <p>1- 01 Nr.17/2013, i datës 29.03.2013,  2 -01 Nr.68/2016, i datës 30.06.2016,  3- 01 Nr.29/2019, i datës 29.03.2019,  4- 01 Nr.30/2019, i datës 29.03.2019,  5 -01 Nr.31/2019, i datës 29.03.2019,  6 -01 Nr.32/2019, i datës 29.03.2019,  7 -01 Nr.33 2019 , i datës 29.03.2019,</p> <p>Këto janë vendime te marra me herët, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të cilat duhet të anulohen, për shkak që mos të mbetet prona komunale e bllokuar.</p> <p><b>Agim Ademaj, Nënkryetari i Komunës</b> – Prezanton dhe sqaron propozim vendimet për shfuqizim.</p> <p><b>Ajshe Metaj</b> - e kamë një pyetje të shkurtër, këto prona kanë qen edhe të legjislaturës së kaluar, a bon me ditë a ka për obligim dikush ti menaxhoj këto prona dhe pse ka dështuar ky ankand.</p> <p><b>Eliot Kukiqi</b> – kur është shpallur ankandi publik a ka pasur kohë për me i përmbushur ato obligime qe i ka marrë për me funksionuar.</p> <p><b>Nënkryetari i Komunës</b> – ka dështuar ankandi, ankandi është shpallur nuk ka pasur konkurrent ka qenë një ofertues për shkak të procedurave ka dështuar.</p> <p><b>Kryesuesi i Kuvendit</b> – pasi që diskutime tjera nuk ka.  Konstatojmë se në mënyrë unanime Komiteti për Politikë dhe Financa, i rekomandon Kuvendit këtë pike të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim.</p>	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që: Marrja e vendimit për shfuqizimin e vendimeve: <p>1- 01 Nr.17/2013, i datës 29.03.2013,  2 -01 Nr.68/2016, i datës 30.06.2016,</p>	

3- 01 Nr.29/2019, i datës 29.03.2019, 4- 01 Nr.30/2019, i datës 29.03.2019, 5 -01 Nr.31/2019, i datës 29.03.2019, 6 -01 Nr.32/2019, i datës 29.03.2019, 7 -01 Nr.33 2019 , i datës 29.03.2019, të njëjtat i kalohe Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Diskutime tjera:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
Mbledhja përfundoj :	11:35

Procesmbajtëse,  
Znj. Vjosa Hysenaj




Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Qaush Balaj

